

Trusti



FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

BULETINI TREMUJOR
NR 56 -- VITI XIV -- TM4 2021

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	2.04%	4.14%	10.65%	24.12%	25.20%	72.22%
BENÇMARKU*	0.44%	2.72%	6.69%	8.02%	11.75%	48.40%

*Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

LËVIZJET MUJORE

NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT	KTHIMI BRUTO (MLN)	KTHIMI NETO (MLN)	
Tetor	2.34%	€52.70	€51.94
Nëntor	-0.28%	€(5.77)	€(6.52)
Dhjetor	2.04%	€47.66	€46.91
Tremujori	4.14%	€94.59	€92.33

KONTRIBUIMI

KONTRIBUTET E REJA (MLN)	LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE	
Tetor	€19.80	4,533	399,717
Nëntor	€17.56	5,776	411,477
Dhjetor	€19.44	4,119	419,654
Tremujori	€56.80	14,428	410,283*

*mesatarja tremujore

PENSIONIMET

TË PENSIONUAR	SHUMA E TËRHEQUR (MLN)	
Tetor	547	€4.10
Nëntor	525	€3.49
Dhjetor	515	€3.25
Tremujori	1,587	€10.84

ARSYET		
PENSION MOSHE	RASTE VDEKJESH	TË TJERA
405	94	48
340	81	104
295	86	134
1,040	261	286

PËRMBLEDHJE SHIFRASH

	TM4 2021	TM3 2021
ÇMIMI I AKSIONIT	€1.7222	€1.6538
MJETET NETO NËN MENAXHIM	€2,353,174,908	€2,215,508,793
TARIFA INVESTUESE	€633,757	€1,835,935
TARIFA OPERACIONALE	€128,731	€361,624
INVESTIMET NË KOSOVË	€536,279,867	€542,014,438
INVESTIMET JASHTË	€1,808,309,791	€1,646,224,438
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€9,313,041	€28,317,806
LLOGARI NË eTRUSTI GJITHSEJ	274,718	266,943
SHËRBIMET E OFRUARA NGA ZYRA E FKPK-së	82,248	49,412

PLASMANET DHE PERFORMANCA

MENAXHUESI FONDI BANKA BROKERI	NUMRI ISIN / LLOJI INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI I TM4	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€13,065,131.99	€6,272,694.09
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€359,813,946.27	€14,219,245.24
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€90,711,376.39	€5,188,378.94
BNY Mellon RRF	IE00B504KX99	€367,648,406.80	€14,547,275.51
AXA GILB	LU0227145629	€22,853,728.38	€596,454.87
Amundi Euro Liquidity-Rated SRI	FR0007038138	€364,551,203.72	€(339,094.91)
BNP Parvest DD	LU0102035119	€51,971,085.41	€1,251,484.05
iShares Edge S&P 500 MinVol	IE00BYX8XD24	€11,346,297.25	€1,207,848.66
iShares Edge MSCI Europe	IE00B86MWN23	€15,033,404.22	€1,251,008.97
Invesco QQQ UCITS	US46090E1038	--	€9,721,175.48
Amundi MSCI Eu Qual Fact	LU1681041890	€73,446,590.00	€6,459,133.70
SP OilGas Expl ETF	US91232N2071	--	€838,086.23
FirstT CybrSec ETF	US33734X8469	€27,402,701.19	€5,418,525.17
L&G E-commerce and Logistics	IE00BF0M6N54	€39,161,984.50	€145,553.62
US Infrastructure Dev ETF	US37954Y6730	€46,032,602.28	€5,261,927.35
US Infrastructure ETF	US46435U7138	€44,270,330.65	€4,552,920.44
Real Estate US ETF	US9229085538	€45,947,140.42	€5,275,122.31
Pacer Industrial Real Estate	US69374H7668	€33,917,670.08	€3,848,859.39
Invesco DB Base Metals ETF	US46140H7008	€45,807,075.29	€3,979,417.33
iShares Global Clean Energy ETF	US4642882249	€9,706,952.00	€(3,920.00)
First Trust Green Energy Fund	US33733E5006	€13,272,813.74	€3,601,766.01
Schroder ISF Global Sustainable Growth	LU2305367323	€20,751,368.24	€751,368.24
BNP Climate Impact	LU0406802768	€19,719,792.58	€(255,289.12)
AXA WF - Framlington Digital Economy	LU1694772994	€23,919,668.21	€(1,059,033.26)
T. Rowe - Global Technology Equity	LU1244139827	€17,969,996.92	€(2,012,882.57)
Amundi Global Disruptive	LU1530899811	€24,173,176.60	€(800,730.28)
Goldman Sachs Global Millennials	LU1820776075	€25,815,347.71	€825,698.60
Thesari i Kosovës ¹⁾	Letra me vlerë të Qeverisë	€491,503,672.16	€2,840,826.75
Banka në Kosovë ¹⁾	Depozita bankare	€44,776,194.59	€177,235.34
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€9,313,040.82	€(47,025.80)
Të hyra të tjera	--	--	€878,487.90
GJITHSEJ		€2,353,902,698.41	€94,592,518.25

¹⁾ Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

LAJME

<p>+227 MLN EURO KTHIMI NGA INVESTIMET PËR VITIN 2021</p>	<p>Fondi i Kursimeve Pensionale e përmbylli vitin 2021 me rezultat shumë të kënaqshëm nga investimet, me kthimin bruto që kapi shumën prej +227 milionë euro. Kjo shifër nominale është më e larta prej themelimit të institucionit. Ndërsa rritja e çmimit të njësisë për këtë vit ishte 10.65%, krahasuar me rritjen prej +3.03% për vitin 2020.</p> <p>Në total mjetet pensionale u rritën me 365 milionë euro këtë vit, duke shkuar në 2.35 miliardë euro. Në fund të 2021-s rreth 77% e mjeteve nën menaxhim ishin të investuara në tregjet financiare ndërkombëtare, kurse pjesa tjetër në Kosovë – sipas kritereve të përcaktuara me ligj. Investimet në tregjet financiare ndërkombëtare vazhdojnë të kontribuojnë me rreth 95% në totalin e performancës investuese.</p> <p>Sikurse kërkohet në parimet e vendosura në Ligjin mbi Fondet Pensionale dhe bazuar në strategjinë investuese të FKPK-së, Bordi Drejtues përgjatë vitit 2021, i ndihmuar nga menaxhmenti e stafi profesional i FKPK-së, ka ndërmarrë mbi 40 vendime për alokime të ndryshme të mjeteve pensionale. Duke konsideruar se 2021-shi ishte vit i afektuar nga pandemia, luhatshmëria në tregjet financiare dhe lëvizjet e ndryshme makroekonomike, strategjia investuese e FKPK-së është adaptuar në baza të rregullta, duke angazhuar edhe fonde të reja, për të mbajtur likuiditetin, sigurinë dhe diversifikimin e portofolit.</p> <p>Pritjet janë që viti 2022 të ketë luhatshmëri të lartë për shkak të pandemisë, vonesave në zinxhirin furnizues, inflacionin, rritjen e kamatave nga bankat qendrore dhe faktorët e tjerë gjeostrategjikë. Rrjedhimisht Bordi Drejtues mbetet i përkushtuar që të veprojë sipas kushteve dhe lëvizjeve në tregjet financiare.</p>
<p>KUVENDI I KOSOVËS E MIRATOI RAPORTIN VJETOR PËR VITIN 2020</p>	<p>Kuvendi i Kosovës, në seancën e mbajtur më 22 nëntor 2021, e ka shqyrtuar Raportin Vjetor 2020 të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Raporti është prezantuar në Kuvend nga Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere. Anëtarët e këtij Komisioni e kishin diskutuar dhe miratuar unanimisht këtë raport në nivel të Komisionit, andaj i rekomanduan edhe Kuvendit miratimin.</p> <p>Deputetët e deklaruar në seancë e vlerësuan tejet kënaqshëm përmbajtjen dhe përgatitjen e këtij raporti, duke e vënë në pah performancën e investimeve gjatë vitit 2020 në kushtet e situatës pandemike. Po ashtu u vlerësua edhe shërbimi i ofruar pa ndërprerje dhe mbrojtja e interesit të kontribuuesve në afatgjatë. Në fund, deputetët e votuan unanimisht raportin.</p> <p>Në këtë seancë, po ashtu deputetët e shqyrtuan dhe i votuan taksat menaxhuese për vitin 2021.</p> <p>Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së e çmojnë këtë vlerësim dhe mbështetje nga institucioni më i lartë vendimmarrës në vend.</p>
<p>VENDIMET E BORDIT DREJTUES PËR INVESTIMET</p>	<p>Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, pas konsultimeve të të gjithë anëtarëve, më 29 nëntor 2021 ka vendosur sikurse në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të shiten nga Vanguard Global Stock Index Fund 100 milionë euro, – Të shitet i gjithë investimi nga fondi i tregtueshëm i naftës USO Oil ETF (rreth 48.14 milionë euro), – Të shitet i gjithë investimi nga fondi i tregtueshëm Invesco Nasdaq ETF (rreth 79.95 milionë euro). <p>Ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2021, Bordi Drejtues i mori këto vendime për dërgimin e mjeteve shtesë në këto fonde investuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> – €20 mln në fondin e Pacer Benchmark Industrial Real Estate ETF US69374H7668; – €10 mln në fondin e Vanguard REIT ETF US9229085538; – €10 mln në fondin e iShares US Infrastructure ETF US46435U7138; – €10 mln në fondin e Global X US Infrastructure ETF US37954Y6730.

PUBLIKON:

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Janar 2022

AUTOR:

Jeton Demi

ADRESA:

Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL & UEB

info@trusti.org | www.trusti.org

Facebook:

TrustiPensional

Youtube:

Fondi Pensional i Kosovës